

BULETINI TREMUJOR

Nr. 45 - VITI XII - TM1 2019

FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE I KOSOVËS

TRUSTORJA

PERFORMANCA

PERIUDHA	1M	3M	VITI AKTUAL	3V	5V	NGA THEMELIMI
REZULTATI	0.58%	5.56%	5.56%	10.84%	19.74%	46.46%
BENÇMARKU*	0.09%	0.86%	0.86%	4.86%	4.55%	38.57%

*INDEKSI I HARMONIZUAR I ÇMIMEVE TË KONSUMIT I PUBLIKUAR NGA AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS

LËVIZJET MUJORE

ÇMIMI I AKSIONIT:

JANAR	▲ +3.22%
SHKURT	▲ +1.67%
MARS	▲ +0.58%
TREMUJORI	▲ +5.56%

KTHIMI BRUTO [euro]

JANAR	54.95 mln
SHKURT	29.84 mln
MARS	11.14 mln
TREMUJORI	95.93 mln

KTHIMI NETO [euro]

JANAR	54.29 mln
SHKURT	29.22 mln
MARS	10.45 mln
TREMUJORI	93.96 mln

KONTRIBUIMI

KONTRIBUTE TË REJA [euro]

JANAR	16.64 mln
SHKURT	13.70 mln
MARS	14.06 mln
TREMUJORI	44.40 mln

LLOGARI TË REJA

JANAR	3,406
SHKURT	2,843
MARS	2,700
TREMUJORI	7,717

LLOGARI AKTIVE

JANAR	344,376
SHKURT	245,376
MARS	267,092
TREMUJORI	287,010

MESATARJA TREMUJORE

PENSIONIMET

PËRFITUES PENSIONI

JANAR	730
SHKURT	456
MARS	471
TREMUJORI	1,657

VLERA E TËRHEQUR

JANAR	€3.94 mln
SHKURT	€2.82 mln
MARS	€2.91 mln
TREMUJORI	€9.67 mln

ARSYET

PENSION MOSHE	RASTE VDEKJESH	TË TJERA
€3.59 mln	€0.31 mln	€0.04 mln
€2.32 mln	€0.45 mln	€0.05 mln
€2.44 mln	€0.43 mln	€0.04 mln
€8.35 mln	€1.19 mln	€0.13 mln

PËRMBLEDHUR

	TM1 2019	TM4 2018
ÇMIMI I AKSIONIT	€1.4646	€1.3875
MJETET NËN MENAXHIM	€1,811,435,558	€1,682,023,592
TARIFA INVESTUESE	€1.66 mln	€1.64 mln
TARIFA OPERACIONALE	€0.31 mln	€0.31 mln
INVESTIMET NË KOSOVË	€374.82 mln	€328.45 mln
INVESTIMET JASHTË	€1426.38 mln	€1,353.58 mln
TË PAINVESTUARA (NË BQK)	€10.24 mln	€126.26 mln
LLOGARI NË eTRUSTI	112,332	102,727
SHËRBIMET E OFRUARA	28,366	21,767



KREATIVITET
ORGANIZIM
DREJTIM
- JETË!

PLASMANET DHE PERFORMANCA

MENAXHUESI/ FONDI / BANKA	EMËRTIMI I FONDIT	PLASMANET FUNDI TM1 (€)	PJESËMARRJA MESATARE	PERFORMANCA MESATARE	KTHIMI BRUTO NË INVESTIME (€)
Vanguard	Global Stock Index Fund - Euro	€119,485,937	21.16%	10.22%	40.90 mln
Nordea	1-Stable Return Fund	€186,890,671	9.11%	4.57%	7.88 mln
Nordea	1-Global Stable Equity Fund	€61,023,145	11.01%	10.68%	21.41 mln
BNY Mellon	Global Real Return Fund	€183,822,005	10.12%	4.53%	8.56 mln
AXA	Global Inflation Linked Bonds	€28,913,014	3.78%	1.56%	1.37 mln
AXA	WF Optimal Income I EUR	€39,926,401	2.95%	6.93%	3.59 mln
Schroders	ISF Global Diversified Growth	€41,183,704	3.06%	4.33%	2.79 mln
Amundi	Rendement Plus Part I2	€56,283,295	5.37%	3.76%	3.81 mln
Amundi 3M	Amundi 3M - I	€627,782,789	4.95%	-0.06%	-0.05 mln
BNP Parvest	Diversified Dynamic	€56,097,997	3.09%	6.78%	3.98 mln
Schroders	Strategic Bond - Euro Hedged	€24,969,505	1.15%	0.95%	0.15 mln
Thesari i Kosovës*	Obligacione	€213,792,337	10.75%	0.52%	1.04 mln
Thesari i Kosovës*	Fletobligacione	€41,169,864	2.33%	0.12%	0.03 mln
BKT, BPB, TEB, NLB*	Depozita me afat	€119,857,913	6.79%	0.37%	0.45 mln
BQK - të gatshme	Të painvestuara	€10,235,467	4.39%	-0.04%	-0.03 mln
GJITHSEJ		€1,811,434,045	100.00%	5.11%	95.93 mln

*Performanca është e bazuar në norma fikse të interesit.

LAJME

GUVERNATORI I BQK-SË PRITI NË TAKIM DREJTUES TË FKPK-SË

Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), z. Fehmi Mehmeti, ka pritur në fund të janarit drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës. FKPK në këtë takim përfaqësohej nga Kryesuesi i Bordit Drejtues, z. Ruzhdi Morina, i cili shoqërohej nga anëtarë të Bordit Drejtues dhe Drejtori Menaxhues i FKPK-së. Guvernatori, Z. Mehmeti, është interesuar për gjendjen e investimeve të FKPK-së, rezultatin e vitit 2018 dhe për veprimet që Bordi Drejtues pritet t'i marrë gjatë vitit në vijim.

Nga ana tjetër, Kryesuesi i Bordit, z. Morina, e ka njoftuar Guvernatorin rreth zhvillimeve të lidhura me investimet e FKPK-së në tregjet financiare ndërkombëtare, duke theksuar se rënia e shënuar në tremujorin e fundit të vitit 2018, sidomos me dhjetorin më të keq në histori të tregjeve financiare, deri në një masë është kompensuar me kthimin pozitiv që kanë shënuar investimet e FKPK-së gjatë muajit janar 2019, dhe se varësisht prej zhvillimeve në vijim Bordi do të marrë vendime për lëvizjen e mjeteve.

Guvernatori, z. Mehmeti, ka vlerësuar se Bordi Drejtues duhet t'i qëndrojë strategjisë së saj të investimeve me fokus afatgjatë, por të shikojë edhe si t'i menaxhojë luhatshmeritë afatshkurtra në mënyrë efektive.

BORDI ZHVILLOI TRITAKIME GJATË TM1, NGA NJË PËR ÇDO MUJ

Në mbledhjen e janarit, bazuar në rekomandimet e Komisionit të Investimeve, Bordi Drejtues unanimisht kishte miratuar vendimet për tërheqjen e €70 mln nga fondi i Amundi 3M. Po ashtu Bordi vendosi që këto mjete të plasohen si në vijim: €20 mln në Vanguard GSEF; €20mln në Nordea GSE; €20 mln në Nordea SRF, dhe €10 mln në Schroders SB.

Në mbledhjen e shkurtit, Bordi mori vendim për tërheqjen e €45 mln nga AXA-GILB dhe tërheqjen e €30 mln nga Amundi 3M. Po ashtu, Bordi vendosi që këto shuma të tërhequra të plasohen tek fondet në vijim: €5 mln në fondin e Schroders SB; €35 mln në fondin e Vanguard GSIF dhe €35 mln në fondin e Nordea SRF.

Ndërsa në mbledhjen e marsit, me qëllim të balancimit taktik, Bordi unanimisht miratoi vendimet për tërheqjen e mjeteve në vijim: €160 mln nga Vanguard GSIF, €80 mln nga Nordea GSEF, €25 mln nga AXA GILB, €50 mln nga Amundi RP, €17.5 mln nga AXA OI dhe €17.5 mln nga Schroders GDG. Njëkohësisht Bordi vendosi që e gjitha shuma e tërhequr [pra €350 mln] të investohen në fondin e Amundi 3M-I.

FILLOI DËRGIMI I PASQYRAVE VJETORE

Në ciklin e vitit 2018 janë gjeneruar nga sistemi i menaxhimit të llogarive në FKPK gjithsej 382,291 pasqyra. Nga ky numër me shërbimin e rregullt postar do të dërgohen 204,691 ndërsa 177,600 janë dërguar me e-mail. Përkundër që numri i llogarive të reja këtë vit është rritur për rreth 35 mijë, numri i pasqyrave të dërguara me Postë është ulur ndjeshëm [për rreth 79 mijë një vit më parë]. Kjo për shkak se është rritur për rreth 20 mijë numri i përdoruesve në shërbimin eTrusti, të cilëve nuk ka nevojë t'ju dërgohet pasqyrave fizike, por edhe janë siguruar më shumë adresa e-maili të kontribuuesve.

BOTUES

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
Prill 2019

AUTOR

Jeton Demi

ADRESA

Rr. "Agim Ramadani" #182-184
10000 Prishtinë, Kosovë

E-MAIL DHE UEB

info@trusti.org
www.trusti.org

